



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prilbato Received / Delivered	13.04.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMVSHTK	1747/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.119/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 03.03.2021 me numër A.nr.119/2021, e parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Imzot Nik Prela", E30/3C, Nr.20 në Ulpian Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër protokoll 03/02-34 të datës 18.01.2021 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike "Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.119/2021 e datës 03.03.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e sistemuar në pozitë "Zyrtar i lartë i prokurimit", në Policinë e Kosovës, sipas Kontratës së punës të datës 17.03.2021 me nr. Referencë 07/1-01SAP-P/1830, bazuar në Urdhëresë e datës 02.09.2020 nr. Referencë 07/1-01SAP-P/4396 për ekzekutim të Aktgjykimit Ac.nr.4252/18 të datës 01.07.2020 të Gjykatës së Apelit, për të cilin është nxjerrë Vendimi i datës 03.09.2020 nr. Referencë 07/1-01SAP-P/4397 për caktim.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 03.09.2020 nr. Referencë 07/1-01SAP-P/4397, ka parashtruar ankesë me datë 16.09.2020 në Komisionin e Ankesave në Policinë e Kosovës, i cili me datë 18.01.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll 03/02-34, me të cilin është shpallur jo kompetent për të vendosur për këtë çështje, duke udhëzuar ankuesen për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja me datë 19.01.2021 pasi ka pranuar Vendimin e datës 18.01.2021 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, me datë 03.03.2021 ka parashtruar ankesë me nr. Protokollin 932/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore kundër Vendimit të datës 18.01.2021 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës dhe kundër sistemimit në pozitë: Zyrtar i Lartë i Prokurimit, në Policinë e Kosovës..

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.03.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 23.03.2021 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.119/2021 me numër protokollin 932/2021 të datës 03.03.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 16.09.2020 në Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime në Policinë e Kosovës, me fletëparaqitje nr.10 të ankesës së datës 16.09.2020; Vendim i datës 03.09.2020 për caktim nr. Reference 07/1-01SAP-P/4397; Urdhëresë nr. reference 07/1-01SAP-P/4396 për ekzekutim të vendimit i datës 02.09.2020; Vendim i datës 15/01/2021 të protokolluar më datë 18.01.2021 i Komisionit për ankesa me nr. Protokollin 03/02-34, të pranuar nga ankuesja më datë 19/01/2021; Aktgjykimi Ac.nr.4252/18 i datës 01.07.2020 i Gjykatës së Apelit; Përgjigje në Ankesë e datës 19/03/2021 e protokolluar më datë 22.03.2021 në polici ndërsa në këshill më datë 23/03/2021; Kontratë e punës nr.reference 07/1-01SAP-P/1830 e datës 17.03.2021; Përshkrimi i detyrave të punës e datës 19.08.2015; Aktgjykim C.nr.3160/2013 i datës 07.05.2018 i Gjykatës Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil; Email i datës 17.03.2021; Email i datës 03.09.2020 (prej 1/2 faqe); Email i datës 01.09.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkrirat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses *është e palejuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datë 03.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka pranuar Vendimin e Komisionit të Ankesave me datës 19.01.2021 të Policisë së Kosovës, me pretendime ankimore kundër sistemimit në pozitë "Zyrtar i lartë i prokurimit" në Sektorin për punë dhe Shërbime në Drejtorinë e Prokurimit /Departamentin Shërbimeve Mbështetëse, pasi që Policia e Kosovës ka pranuar Aktgjykimi Ac.nr.4252/18 i datës 01.07.2020 i Gjykatës së Apelit, për rikthimin e ankueses në marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesja është sistemuar në pozitë "Zyrtar i lartë i prokurimit", në Policinë e Kosovës sipas Kontratës së punës të datës 17.03.2021 me nr.reference 07/1-01SAP-P/1830, bazuar në Urdhëresës të datës 02.09.2020 nr.reference 07/1-01SAP-P/4396 për ekzekutim të Aktgjykimit Ac.nr.4252/18 të datës 01.07.2020 të Gjykatës së Apelit, për të cilin është nxjerrë dhe Vendimi i datës 03.09.2020 nr.reference 07/1-01SAP-P/4397 për caktim, kundër të cilit ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 16.09.2020 në Komisionin e Ankesave në Policinë e Kosovës. Komisioni i Ankesave me datë 18.01.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër protokollin



03/02-34 me të cilin është shpallur jo kompetent për të vendosur për këtë çështje, duke konfirmuar faktin që çështja lëndore duhet ti dërgohet këshillit të pavarur mbikëqyrës për shërbim civil(KPMSHC).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesja Vendimin e datës 18.01.2021 me numër protokollit 03/02-34 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, e ka pranuar me datë 19.01.2021, kurse me datë 03.03.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 932/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 127 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, dhe se ankuesja për realizimin e të drejtës së saj është udhëzuar për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarë Publik.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankueses i ka filluar ti rrjedh afati për ankimim, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëher kur ankuesja ka pranuar Vendimin e datës 18.01.2021 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, ku në shkresat e lëndës gjendet se ankuesja vendimin e ka pranuar me datë 19.01.2021, duke u bazuar në dëshmit e dorëzuara në Këshill nga të dy palët, ku vërtetohet se ankuesja e ka nënshkruar pranimin e vendimit me datë 19.01.2021, si dhe bazuar në deklarinimin elektronik/E-mailit, të zyrës së personelit që dëshmon pranimin e vendimit nga ankuesja me nënshkrimin e saj, me datë 19.01.2021.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se ankesa e ankueses është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka vlerësuar se nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të ankueses, por ka vendosur njëzëri që ta hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankueses të datës 03.03.2021 me numër A.nr.119/2021 të protokolluar me nr.932/2021 datë 03/03/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.119/2021, datë 13.04.2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore/Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

